

ZËRI I POPULLIT RRETH

**'FINALES
SË MADHE'**

NDËRMJET

KOSOVËS DHE SERBISË

VËLLIMI II





Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr.10
Prishtinë 10000
Republic of Kosovo
T/F: +381 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com

***Zëri i Popullit* rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë**

Vëllimi II

Qershor 2019

***Zëri i Popullit* rreth ‘Finales së Madhe’ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë Vëllimi II**

Ky sondazh u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Qershor 2019

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive.....	i
1. Hyrje.....	1
2. Metodologjia	4
2.1. Dizajni i Sondazhit.....	4
2.2. Procedura e Sondazhit.....	4
2.3. Mostra	5
2.4. Karakteristikat e Mostrës	7
2.5. Analiza e të dhënave	11
3. Gjetjet: Rruga përpara dhe prapa	11
3.1. Ndërprerja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë	11
3.2. A duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?	13
3.3. <i>Tre skenarët</i> për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë	16
3.3.1. Skenari i parë: Vazhdimi i status kuo-së.....	17
3.3.2. Skenari i dytë: Njohja de facto nga Serbia, dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës	20
3.3.3. Skenari i tretë: Korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB	24
4. A e mbështesni politikën aktuale të SHBA-së dhe BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?	27
5. Analiza Krahasuese.....	30
6. Përfundimet	33

Përmbledhje Ekzekutive

Qëllimi i këtij sondazhi është identifikimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me skenarët rreth 'finaleve të madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ky sondazh është vazhdim i sondazhit të parë i cili është mbajtur në mes 17-26 dhjetorit 2018. Puna në terren për këtë sondazh u përfundua nga 21-28 maj 2019. Numri i përgjithshëm i 1107 respondentëve në sondazhin tonë (87% shqiptarë, 9% serbë dhe 4% nga grupe tjera etnike) e përbëjnë mostrën tonë përfaqësuese kombëtare të popullsisë së Kosovës. Një pyetësor paraprak u administrua fillimisht në një pilot grup, me qëllim që të bëhen rregullimet përfundimtare të pyetësorit.

Në këtë studim, për secilën komunë është përdorur *mostra e thjeshtë proporcionale*, bazuar në numrin e popullsisë së komunës. Pyetësori është përbërë nga pyetje të hapura dhe të mbyllura. Në mënyrë që të kontrollohet puna e intervistuesve gjatë grumbullimit të të dhënave, rreth 41% (gjithsej 450 respondent) u ri-intervistuan. Kjo kontrollë është bërë nëpërmes intervistave telefonike dhe disa vizitave në terren. Për të kryer procesin e verifikimit, të anketuarit u pyetën për 5 pyetje bazuar në intervistën origjinale. Lista e kontrollit shërbeu si një mjet i rishikimit të parimeve të rastësishme të lokalitetit, pikës fillestare, njësisë së shtëpisë dhe parimin e zgjedhjes së respondentit. Përgjigjet e intervistës së parë dhe të dytë u krahasuan. Përveç procesit të zakonshëm të shqyrtimit, u krye një kontroll logjik i pyetësorëve të plotësuar. Matja prej 95% të kufirit (*margjinës*) së gabimit bazuar në mostrën e plotë është përafërsisht +/-3 pikë përqindjeje. Sidoqoftë, intervalet e konfidencës për vlerësimet e bazuara në nëngrupet e mostrës, siç është mostra serbe prej 94 të anketuarve, do jenë dukshëm më të mëdha.

Sa i përket rezultateve, në paragrafët e mëposhtëm paraqesim gjetjet për çështjet vijuese:

- i) ndërprerja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- ii) në rast të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, a duhet Kosova të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë;
- iii) perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me **tre skenarët** për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- iv) arsyet kryesore për mbështetjen ose mungesën e mbështetjes në lidhje me tre skenarët për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; dhe
- v) mbështetja për politikën e SHBA-ve dhe të BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Grupi i parë i gjetjeve tregon se shumica e popullsisë së Kosovës është kundër ndërprerjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në përgjithësi, **50%** e të gjithë të anketuarve nuk pajtohen me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si shqiptarët ashtu edhe serbët në Kosovë pajtohen që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë. Ekziston mbështetje më e ulët në mesin e shqiptarëve për vazhdimin e dialogut, por një numër i konsiderueshëm i mostrës serbe nuk kanë pasur një pikëpamje mbi këtë pyetje (13%). **49%** në mesin e shqiptarëve dhe **61%** në mesin e serbëve janë shprehur se 'aspak' ose 'disi' nuk pajtohen me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Grupi i dytë i gjetjeve fokusohet në çështjen nëse Kosova duhet të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë, nëse Kosova njihet nga Serbia. Në këtë kontekst, opinioni është i ndarë me, në përgjithësi, **53%** të cilët e përkrahin idenë se Kosova duhet të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse Kosova njihet nga Serbia dhe **40%** e refuzojnë këtë ide. Megjithatë, **38%** në mesin e shqiptarëve dhe **61%** në mesin e serbëve nuk pajtohen me opsionin që Kosova duhet të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia. Grupi i dytë i gjetjeve gjithashtu u përqendrua në arsyet e mundshme për t'u bashkuar ose jo Kosova me

Shqipërinë. Këto janë rezultatet për arsyen se Kosova **duhet të kërkojë** bashkimin me Shqipërinë:

- Të realizojë ëndrrën e disa shqiptarëve për të jetuar brenda një shteti të vetëm (83% e shqiptarëve kundrejt 47% të mostrës serbe);
- Krijon një shtet dhe mjedis më prosperues për të gjithë shqiptarët (82% e shqiptarëve kundrejt 40% të mostrës serbe);
- Stabilizon dhe sjellë paqe në rajonin e Ballkanit përgjithmonë (76% e shqiptarëve kundrejt 33% të mostrës serbe).

Mëposhtë janë rezultatet lidhur me arsyen se pse Kosova **nuk duhet të kërkojë** bashkim me Shqipërinë:

- Është më mirë që Kosova të veprojë si një shtet i veçantë në arenën ndërkombëtare (94% e shqiptarëve kundrejt 25% të mostrës serbe);
- Prosperiteti i Kosovës mund të dëmtohet nga një lëvizje e tillë (60% e shqiptarëve kundrejt 44% të mostrës serbe);
- Nuk do të ishte e drejtë për shqiptarët e tjerë që jetojnë në vende të tjera në rajon (72% e shqiptarëve kundrejt 28% të mostrës serbe).

Grupi i tretë i gjetjeve është i lidhur me perceptimin dhe preferencat e qytetarëve të Kosovës dhe arsyet e mundshme për mbështetjen ose mungesën e mbështetjes për **tre skenarët alternativë** për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kështu, në lidhje me **skenarin e parë-status kuo**-vetëm një numër i vogël i pjesëmarrësve (**7%**) u përgjigjën me 'shumë të kënaqur' ose 'disi të kënaqur' rreth status kuo-së aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Analiza e veçantë e mostrave shqiptare dhe serbe paraqet një model disi të ndryshëm të përgjigjeve. Në këtë kuptim, **91%** në mesin e shqiptarëve në krahasim me **70%** në mesin e serbëve janë 'aspak të kënaqur' ose 'shumë pak të kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Mëposhtë janë rezultatet rreth arsyes që respondentët janë të **kënaqur me status kuo-në aktuale**:

- Të paktën ka paqe mes Kosovës dhe Serbisë (37% e shqiptarëve kundrejt 38% të mostrës serbe);
- Të paktën pengon dëbimin e serbëve nga Kosova (25% e shqiptarëve kundrejt 31% të mostrës serbe);
- Mbanë derën e hapur për ruajtjen e ndikimit të fortë serb në disa pjesë të Kosovës (17% e shqiptarëve kundrejt 38% të mostrës serbe);
- Të paktën kemi prosperitet ekonomik (38% e shqiptarëve kundrejt 0% të mostrës serbe);
- Ka marrëdhënie të mira pune me BE-në dhe OKB-në (52% e shqiptarëve kundrejt 6% të mostrës serbe).

Mëposhtë janë rezultatet rreth arsyes që respondentët **nuk janë të kënaqur me status kuo-në aktuale:**

- Kosova nuk mund të ketë lëvizje konkrete drejt integritetit evropian (88% e shqiptarëve kundrejt 35% të mostrës serbe);
- Ne nuk mund të arrijmë njohjen globale të Kosovës (83% e shqiptarëve kundrejt 18% të mostrës serbe);
- Nuk mund të ketë prosperitet ekonomik (76% e shqiptarëve kundrejt 50% të mostrës serbe);
- Kosova nuk mund të ketë marrëdhënie paqësore me Serbinë (76% e shqiptarëve kundrejt 18% të mostrës serbe);
- Kosova nuk mund të zgjidhë problemet e brendshme ndërmjet komunitetit serb dhe shqiptar (71% e shqiptarëve kundrejt 47% të mostrës serbe).

Sa i përket ***skenarit të dytë-dhënies së kompetencave ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë, në këmbim të njohjes de facto nga Serbia*** – ka gjithashtu pak mbështetje sikurse për skenarin e parë. Vetëm **9%** e të anketuarve janë përgjigjur me *'fuqimisht pajtohem'* ose *'disi pajtohem'* me skenarin e dytë. Ekziston mbështetje e dobët në mesin e shqiptarëve të Kosovës (**5%**), por përkrahje e konsiderueshme në mesin e serbëve (**48%**) për t'i dhënë kompetenca ekzekutive asociacionit/bashkësisë së

komunave me shumicë serbe në Kosovë, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia.

Mëposhtë janë rezultatet rreth arsyes që respondentët **pajtohen me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe të Kosovës:**

- Do të përmirësojë prosperitetin ekonomik në Kosovë (61% e shqiptarëve kundrejt 40% të mostrës serbe);
- Do t'u japë serbëve që jetojnë në Kosovë më shumë zë në procesin e vendimmarrjes (51% e shqiptarëve kundrejt 62% të mostrës serbe);
- Do të përmirësojë integrimin e komunitetit serb në Kosovë (51% e shqiptarëve kundrejt 22% të mostrës serbe);
- Do të përmirësojë marrëdhëniet me Serbinë (43% e shqiptarëve kundrejt 22% të mostrës serbe).

Mëposhtë janë rezultatet rreth arsyes që respondentët **nuk pajtohen me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe të Kosovës:**

- Do të forcojë ndarjet ndërmjet komuniteteve në Kosovë (82% e shqiptarëve kundrejt 24% të mostrës serbe);
- Do të rrisë tensionet politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (80% e shqiptarëve kundrejt 24% të mostrës serbe);
- Do të hapë derën për krijimin e një mini Republika Srpska në Kosovë (89% e shqiptarëve kundrejt 6% të mostrës serbe);
- Do ta bëjë më të vështirë arritjen e prosperitetit ekonomik për Kosovën (73% e shqiptarëve kundrejt 12% të mostrës serbe).

Sa i përket ***skenarit të tretë-korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB***, u gjeneruan të dhënat në vijim: **32%** e mostrës totale shprehën mbështetje për këtë skenar. **32%** në mesin e mostrës shqiptare dhe **33%** në mesin e mostrës serbe janë shprehur se Kosova 'patjetër duhet' ose 'ndoshta

duhet' të mbështesë opsionin e korigjimit të kufirit nëse kjo rezulton në njohjen globale të Kosovës dhe hap rrugën për anëtarësim në OKB.

Mëposhtë janë rezultatet rreth arsyes që respondentët mbështesin **skenarin e korigjimit të kufirit** në këmbim të njohjes globale të Kosovës dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB:

- Korigjimi i kufijve është i drejtë, sepse si Serbia ashtu edhe Kosova gjenerojnë përfitime për popullin e tyre (66% e shqiptarëve kundrejt 0% të mostrës serbe);
- Kosova është një palë fituese në këtë marrëveshje, sepse njohja globale dhe anëtarësimi në OKB ofrojnë përfitime të mëdha për të cilat korigjimi i kufijve është një çmim i vogël për t'u paguar (41% e shqiptarëve kundrejt 50% të mostrës serbe);
- Korigjimi i kufijve në këtë mënyrë do ta bënte Kosovën më të fortë dhe më të bashkuar brenda vendit (57% e shqiptarëve kundrejt 0% të mostrës serbe).

Mëposhtë janë arsyet që respondentët **nuk e mbështesin skenarin e korigjimit të kufirit**:

- Korigjimi i kufijve nuk është i drejtë sepse Serbia përfiton më shumë territor sesa Kosova (85% e shqiptarëve kundrejt 1% të mostrës serbe);
- Kosova është një vend i pavarur të cilit duhet t'i jepet njohja globale dhe anëtarësimi në OKB pa u përfshirë në skenarin e korigjimit të kufijve me Serbinë (93% e shqiptarëve kundrejt 3% të mostrës serbe);
- Përfitimet nga njohja globale dhe anëtarësimi në OKB nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar korigjimin e kufijve (85% e shqiptarëve kundrejt 3% të mostrës serbe);
- Korigjimi i kufijve si ky do ta bëjë Kosovën një vend më të dobët (77% e shqiptarëve kundrejt 10% të mostrës serbe).

Sa i përket *tre skenarëve*, një analizë e shkurtër krahasuese mbi interpretimin e rezultateve gjeneron peisazhin e mëposhtëm: ka pak mbështetje ndërmjet të anketuarve (7% janë shprehur me 'shumë të kënaqur' ose 'disi të kënaqur') për

vazhdimin e status kuo-së (**skenari 1**) dhe pak më shumë (9% u shprehen me 'fuqishëm pajtohem' ose 'disi pajtohem') për dhënien e kompetencave ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia (**skenari 2**). Sidoqoftë, ka më shumë përkrahje (32% e të anketuarve janë shprehur me 'definitivisht duhet' ose 'duhet') lidhur me korrigjimin e kufirit që do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugën për anëtarësim në OKB (**skenari 3**).

Një vlerësim krahasues mes shqiptarëve dhe serbëve lidhur me *tre skenarët* gjeneruan gjetjet pasuese: Një numër i vogël i të anketuarve shqiptarë (6%) dhe më shumë serbë (17%) shprehën kënaqshmërinë e tyre me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (**skenari 1**). 5% në mesin e shqiptarëve dhe 48% në mesin e serbëve shprehën pajtimin e tyre me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia (**skenari 2**). Për dallim nga dy skenarët e mëparshëm, 32% në mesin e shqiptarëve, dhe 33% në mesin e serbëve mbështesin korrigjimin e kufirit që do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugën për anëtarësim në OKB (**skenari 3**).

Grupi i katërt dhe i fundit i gjetjeve është i lidhur me mbështetjen e qytetarëve të Kosovës për politikën e SHBA-së dhe të BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në përgjithësi, 63% pohuan mbështetje për politikën e SHBA-së dhe 37% për politikën e BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 70% në mesin e shqiptarëve në krahasim me 5% në mesin e serbëve mbështesin politikën e SHBA-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në të kundërtën, 39% shqiptarë dhe 11% serbë e mbështesin politikën e BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Shkurtimisht, perspektivat e të dy komuniteteve ndryshojnë fundamentalisht në disa aspekte: të anketuarit serbë treguan shqetësim të veçantë për çështjet e brendshme që prekin komunitetin serb ndërsa të anketuarit shqiptarë, në mënyrë të pamohueshme shpreheshin të shqetësuar për rreziqet e krijimit të një mini Republika Srpska, dhe gjithashtu ishin të shqetësuar për çështjet e jashtme sidomos për integrimin në BE. Megjithatë, këto perspektiva të ndryshme nuk janë domosdoshmërisht kontradiktore reciprocikisht – për shembull integrimi në BE nuk përbënë në vetvete ndonjë zgjidhje specifike për problemet e brendshme ndërmjet dy komuniteteve në Kosovë. Përgjigjet e të anketuarve tanë sugjerojnë se, në këto aspekte, dialogu nuk duhet të jetë një lojë me përfitime të njëanshme 'zero sum game' ku çdo përfitim nga njëra palë duhet të jetë në kurriz të humbjeve për palën tjetër.

1. Hyrje

Sondazhi i parë, *Zëri i Popullit* rreth 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, u realizua në mes 17-26 dhjetor 2018. Pas sondazhit raporti i parë u publikua dhe u prezantua në fillim të shkurtit 2019. Në atë kohë qëllimi i sondazhit ishte të kuptojmë perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve në lidhje me skenarët rreth 'finales së madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në vijim të sondazhit të parë, ne realizuam sondazhin e dytë *Zëri i Popullit* rreth 'Finales së Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Vëllimi II) në mes 21-28 maj 2019. Prandaj, një objektiv tjetër i sondazhit ishte të kuptoheshin më në thellësi motivet dhe qëndrimet e qytetarëve lidhur me skenarët rreth marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Qëllim shtesë i këtij sondazhi ishte të kuptoheshin faktorët që ndikojnë në mbështetjen publike, ose mungesën e mbështetjes, për skenarët e ndryshëm rreth të ashtuquajturës 'finale e madhe'.

Për gati një dekadë dialogu në mes Kosovës dhe Serbisë është lehtësuar nga BE-ja, dhe një numër marrëveshjesh janë arritur. Përderisa progres i konsiderueshëm është arritur në aspektin e lirisë së udhëtimit, menaxhimit të kufijve, mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore, dhe integritit të policisë, shumë marrëveshje të tjera nuk janë zbatuar ose janë zbatuar vetëm pjesërisht nga të dy shtetet.¹

Megjithatë, përkundër progresit dhe disa dështimeve të procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dialogu është ndërprerë që nga nëntori 2018. Kjo për shkak se Qeveria e Kosovës ka vënë një tarifë prej 10% në të gjitha importet e Serbisë dhe Bosnjë Hercegovincës, dhe vendimi fillestar është pasuar me një tarifë 100% për të gjitha mallrat serbe dhe boshnjake.² Ky vendim është

¹ Komisioni Evropian (2013) 'Serbia dhe Kosova*: marrëveshja historike hap rrugën për progres vendimtar në perspektivat e tyre në BE', Deklaratë shtypi, 22 prill. E disponueshme në: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-347_en.htm (Qasur më: 11/06/2019).

² Radio Evropa e Lirë (2018) 'Kosova rrit taksën doganore për Serbinë dhe Bosnjën në 100 përqind', 21 nëntor. E disponueshme në: <https://www.evropaelire.org/a/rritet-taksa-per-produktet-serbe-/29613129.html> (Qasur më: 11/06/2019).

justifikuar nga Qeveria e Kosovës si përgjigje ndaj Qeverisë serbe për politikën e saj agresive në arenën ndërkombëtare kundër integritit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, siç është INTERPOL. Tarifa ka shkaktuar reagime të gjera nga akterët vendor dhe ndërkombëtar, duke përfshirë BE-në dhe SHBA-të. Përfaqësuesja e Lartë/Zv.kryetarja e Komisionit Evropian Federica Mogherini ka kundërshtuar tarifën duke theksuar se është shkelur marrëveshja tregtare e CEFTA-s. Për më tepër, Përfaqësuesja e Lartë i kërkoi Qeverisë së Kosovës që menjëherë të tërheq vendimet.³ Këto hapa e kanë vënë dialogun në rrezik, ndërsa Serbia dhe Kosova vazhdojnë të mbesin në pozita antagonistë. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovës ka kërkuar pezullimin e menjëhershëm të taksës për importet nga Serbia dhe Bosnja, duke e konsideruar pezullimin si një masë të nevojshme për të rivendosur momentumin e procesit të dialogut.⁴

Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve u rihurua përsëri në Berlin më 29 prill 2019, në një ngjarje të inicuar dhe organizuar nga Kancelarja Gjermane Angela Merkel dhe Presidenti Francez Emanuel Macron. Përkundër faktit se ngjarja mbledhi të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, në qendër të diskutimeve ishin marrëdhëniet Kosovë-Serbi.⁵ Edhe pse takimi kishte për qëllim rivendosjen e dialogut, megjithatë taksa nuk është tërhequr dhe dialogu mbetet i bllokuar. Takimi i Berlinit ka prodhuar qëndrime diametralisht të kundërta mbi mënyrën e vazhdimit të dialogut. Deri tani, debati politik mbi tarifën e vëna dhe mbi skenarët e mundshëm për Marrëveshjen Përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ende vazhdon. Megjithatë, që nga marsi 2019, roli i akterëve ndërkombëtar ka pësuar një ndryshim të vogël, me Gjermaninë dhe Francën që kanë vënë përpjekjet e tyre për të luajtur një rol më aktiv, dhe kemi një qasje aktualisht më pasive nga Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, Presidenti i

³Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian (2018) 'Prononcimi i Federica Mogherinit mbi vendimin e Qeverisë së Kosovës për tatimin e mallrave nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina', Prononcim, 21 nëntor. E disponueshme në: <https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/54242/statement-federica-mogherini-kosovo-government-decision-taxing-goods-serbia-and-bosnia-and-en> (Qasur më: 11/06/2019).

⁴Ambasada e SHBA-së në Kosovë (2019) 'Prononcim nga Ambasada e SHBA-së në Prishtinë', 22 janar. E disponueshme në: <https://xk.usembassy.gov/statement-from-u-s-embassy-pristina-2/> (Qasur më: 11/06/2019).

⁵Ballkani Perëndimor Evropian (2019) 'Gjermania të rifillojë dialogun Kosovë-Serbi me takimin e Berlinit'.

Kosovës, Hashim Thaçi ka theksuar se asnjë marrëveshje nuk mund të arrihet pa rolin vendimtar të Shteteve të Bashkuara në procesin e dialogut.⁶

Pavarësisht të gjitha fakteve dhe kontekstit të ndërlikuar kohor të dialogut, duke u bazuar në diskutimet dhe analizat e politik-bërësve të ndryshëm dhe akterëve relevantë vendimmarrës në Kosovë dhe Serbi, si dhe në nivelin ndërkombëtar, skenarë të ndryshëm potencial për një Marrëveshje Përfundimtare mund të përvijohen. Këta skenarë për të përmendur vetëm disa përfshijnë: kompetencat ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe, korrigjimin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 'modelin e dy Gjermanive' dhe kështu me radhë. Në këtë kontekst, raporti i tanishëm hulumtues ka për qëllim të përshkruaj dhe dekonstruktoj shtrirjen e mbështetjes publike në mesin e qytetarëve të Kosovës për skenarë të mundshëm mbi Marrëveshjen Përfundimtare gjithëpërfshirëse që do të ishte ligjërisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ky raport hulumtues përveç çështjeve të tjera ofron një analizë të detajuar të gjetjeve mbi skenarët kryesorë të mundshëm për një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe motivet që i shtyjnë qytetarët drejt, ose larg, çdo skenari të dhënë. Ky raport fokusohet në tre skenarë kryesorë të mundshëm: a) vazhdimi i status kuo-së; b) njohja de facto nga Serbia, në këmbim të kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës; dhe c) korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe një rrugë konkrete për anëtarësim në OKB.

Përveç kësaj, raporti hulumtues përshkruan dhe analizon mbështetjen e qytetarëve për politikën e SHBA-së dhe BE-së drejt procesit të dialogut, dhe Marrëveshjes së mundshme përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Përderisa këto janë disa nga çështjet kryesore dhe skenarët e shqyrtuar, në këtë raport hulumtues do të diskutohet

⁶Radio Evropa e Lirë (2019) 'Samiti i pritjeve, por edhe i mosmarrëveshjeve të mëdha', 21 prill. E disponueshme në: <https://www.evropaelire.org/a/samiti-i-berlinit-/29912751.html> (Qasur më: 11/06/2019).

gjithashtu edhe një numër i konsiderueshëm i varianteve dhe opsioneve të mundshme.

2. Metodologjia

2.1. Dizajni i Sondazhit

Pyetëtori i këtij sondazhi përbëhet nga pyetjet e mbyllura me strukturën vijuese: të dhëna demografike për pjesëmarrësit, perceptimin e tyre, qëndrimin dhe mbështetjen, ose mungesën e mbështetjes për skenarët/opsionet e mundshëm për Marrëveshjen Përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Fillimisht, pyetëtori u administrua nga një pilot grup prej 30 të anketuarve për të bërë testimin e kuptueshmërisë nga të anketuarit dhe korrigjimet përfundimtare në pyetësor.

2.2. Procedura e Sondazhit

Ekipi hulumtues përbëhej nga 15 intervistues në terren (2 për secilin prej 7 rajoneve të Kosovës, plus 2 intervistues special për të anketuarit serbë në Kosovë) dhe 4 hulumtues, eksperti kryesor, dhe 2 ekspertë të lartë dhe një hulumtues i ri. Puna e tyre rezultoi në raportin aktual të hulumtimit. Intervistuesit në terren i administruan pyetësorët me tablet elektronik duke përdorur softuerin e dizajnuar posaçërisht për këtë studim. Pyetëtori u plotësua nga intervistuesit në terren për të siguruar që nuk kishte mungesë të të dhënave. Megjithatë, të anketuarit ishin të lirë të mos i përgjigjeshin pyetjeve. Për të shmangur paragjykimin e intervistimit, ekipi hulumtues i trajnoi të gjithë intervistuesit në terren për zbatimin e sondazhit.


Për të kontrolluar punën e intervistuesve gjatë mbledhjes së të dhënave, rreth 41% (gjithsej 450 të anketuar) u ri-intervistuan. Ky kontroll është bërë përmes intervistave telefonike dhe disa vizitave në terren. Si kontroll, të anketuarve u pyetën rreth 5 pyetje bazuar në intervistën origjinale. Lista e kontrollit shërbeu

si një mjet për rishikimin e pajtueshmërisë me parimin e përzgjedhjes së rastësishme të të anketuarve (që mbulojnë përzgjedhjen e lokalitetit, pikën fillestare, njësinë e shtëpisë dhe përzgjedhjen e të anketuarit). Përgjigjet e intervistës së parë dhe të dytë u krahasuan. Përveç procesit të zakonshëm të kontrollit, u krye një kontroll logjik i pyetësorëve të plotësuar.

2.3. Mostra

Sondazhi u krye në 38 komuna të 7 rajoneve kryesore në Kosovë: Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë (Veri dhe Jug, shih hartën më poshtë). Kosova ka një popullsi prej 1,798,506 banorë⁷. Në këtë sondazh, për secilën komunë është përdorur mostra e thjeshtë proporcionale, bazuar në madhësinë e popullsisë së komunës, që është në raport me numrin e popullsisë së regjistruar në një komunë specifike me numrin e përgjithshëm të banorëve të regjistruar në Kosovë. Përqindja që rezulton përcakton peshën e secilës komunë në mostër. Baza e popullsisë së regjistruar është nxjerrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁷Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018) "Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018". E disponueshme në: <http://ask.rks-gov.net/media/4369/statistical-yearbook-2018.pdf> (Qasur më: 11/06/2019).




Pyetësorët u administruan në shtëpitë dhe banesat e të anketuarve. Për të përcaktuar mostrën e studimit është përdorur procedura e mostrës së rastësishme, me rregullat e përcaktuara për zgjedhjen e pikës fillestare, dhe përzgjedhjen pasuese të rrugës, ndërtesës, banesës dhe respondentit. Pyetësori u administrua vetëm tek një anëtar i familjes. Kjo është bërë në këtë mënyrë për të shmangur njëanshmërinë e mostrës.

Për të pasur një mostër mjaftueshëm të madhe të serbëve për analiza të përdorshme, mostra është dyfishuar në dy komunat kryesore serbe Mitrovicë Veriore (në veri të Kosovës) dhe Graçanicë (në jug të Kosovës). Kjo dha një mostër prej 94 respondentëve serbë në vend të 50 të anketuarve që do të ishin marrë po të mos dyfishonim numrin e mostrës.

2.4. Karakteristikat e Mostrës

Numri i përgjithshëm i të anketuarve në këtë sondazh është 1107. Me një mostër të kësaj madhësie, kufiri i gabimit në vlerësim është plus ose minus 3 pikë përqindje (në nivel të rëndësisë 5 përqind). Vini re që, gabimi i marrjes së mostrave mund të jetë shumë më i madh kur vlerësimet janë vetëm për mostrën serbe prej 94 të anketuarve: me një mostër prej 94, intervali i konfidencës prej 95% do të jetë përafërsisht plus ose minus 1 pikë përqindjeje. Të gjitha dallimet ndërmjet mostrave serbe dhe shqiptare janë kontrolluar për rëndësi statistikore.

Siç është thënë më lart, studimi është kryer në të gjitha (shtatë) rajonet e Kosovës dhe (tridhjetë e tetë) komunat. Shih mëposhtë shpërndarjen e mostrës në shtatë rajonet.



Numri i intervistave për secilën komunë është caktuar në bazë të numrit të popullsisë në secilën komunë dhe shpërndarja e mostrës së arritur kështu korrespondon ngushtë me shpërndarjen e popullsisë. Shih mëposhtë tabelën që përshkruan numrin e popullsisë bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës⁸ dhe numrin e intervistave të realizuara nëpër komuna.


⁸Po aty.

Tabela 1. Madhësia e popullsisë dhe numri i intervistave për komunë			
Nr	Komuna	Popullsia	Nr. i të intervistuarve
1	<i>Ferizaj</i>	<i>103,003</i>	<i>63</i>
2	<i>Shtime</i>	<i>27,654</i>	<i>35</i>
3	<i>Kaçanik</i>	<i>33,409</i>	<i>20</i>
4	<i>Shtërpcë</i>	<i>6,773</i>	<i>8</i>
5	<i>Hani i Elezit</i>	<i>9,998</i>	<i>6</i>
6	<i>Gjakovë</i>	<i>95,340</i>	<i>58</i>
7	<i>Rahovec</i>	<i>59,102</i>	<i>36</i>
8	<i>Deçan</i>	<i>41,808</i>	<i>26</i>
9	<i>Junik</i>	<i>6,370</i>	<i>4</i>
10	<i>Gjilan</i>	<i>80,162</i>	<i>48</i>
11	<i>Kamenica</i>	<i>30,750</i>	<i>19</i>
12	<i>Viti</i>	<i>47,615</i>	<i>29</i>
13	<i>Ranillug</i>	<i>3,810</i>	<i>3</i>
14	<i>Novobërdë</i>	<i>7,160</i>	<i>5</i>
15	<i>Partesh</i>	<i>1730</i>	<i>2</i>
16	<i>Klllokot</i>	<i>2,753</i>	<i>2</i>
17	<i>Mitrovicë</i>	<i>69,346</i>	<i>44</i>
18	<i>Vushtrri</i>	<i>64,468</i>	<i>39</i>
19	<i>Mitrovica Veriore</i>	<i>12,211</i>	<i>40</i>
20	<i>Zveçan</i>	<i>7,376</i>	<i>5</i>
21	<i>Zubin Potok</i>	<i>6,616</i>	<i>5</i>
22	<i>Leposaviq</i>	<i>13,587</i>	<i>8</i>
23	<i>Skenderaj</i>	<i>52,343</i>	<i>32</i>
24	<i>Pejë</i>	<i>99,568</i>	<i>61</i>
25	<i>Istog</i>	<i>40,380</i>	<i>11</i>
26	<i>Klin</i>	<i>40,122</i>	<i>12</i>
27	<i>Prishtinë</i>	<i>211,755</i>	<i>131</i>
28	<i>Obiliq</i>	<i>19,144</i>	<i>12</i>

29	Fushë Kosovë	38,607	24
30	Lipjan	57,733	35
31	Podujevë	83,445	51
32	Glllogoc	61,133	19
33	Graçanicë	12,091	20
34	Prizren	191,565	112
35	Suharekë	60,247	21
36	Malishevë	58,269	36
37	Mamushë	5,950	4
38	Dragash	34,316	21
Totali		1,798,506	1107

87% e mostrës së studimit ishin shqiptarë, 9% serbë dhe 4% ishin nga grupe tjera etnike në Kosovë. Përqindja shqiptare e mostrës korrespondon ngushtë me regjistrimin e vitit 2011, gjë që tregon se 91% ishin shqiptarë, 3.4% serbë dhe 5.6% 'të tjerë'. Proporcioni relativisht i madh serbë në mostër pasqyron dyfishimin e mostrës për popullësinë serbe. (Numri i vogël i grupeve etnike 'të tjera' është shumë i vogël për analiza të dobishme dhe nuk ofron një bazë të besueshme për të matur).

55.5% e mostrës së studimit janë meshkuj dhe 44.5% janë femra. Moshë mesatare e mostrës është 41 vjeç dhe moshë ka një shtrirje prej 18-91 vjeç. Mëposhtë është shpërndarja e mostrës sipas grupmoshës.



Krahasuar me shifrat e regjistrimit për vitin 2011, meshkujt dhe të rinjtë janë të mbi-përfaqësuar në mostrën e arritur (edhe pse më pak se në sondazhin e parë). Për më tepër, as mosha e as gjinia nuk janë të lidhura fuqishëm me shpërndarjen e variablave në të cilat fokusohet ky raport. Për këtë arsye ne kemi raportuar thjesht përqindjet e pamatura.

Sa i përket nivelit të arsimimit, 1% e mostrës ka deklaruar se nuk kanë diplomë shkollore, 3% kanë deklaruar vetëm arsim fillor (1-5 klasë), 15% kanë deklaruar arsim të mesëm të ulët (6-9 klasë), 44% shkollë të mesme të lartë (gjimnaz ose shkollë profesionale), 2% arsim profesional pas shkollës së mesme, 29% kanë deklaruar se kanë diplomë universitare (Bachelor), 5% kryesisht me Master, dhe pak me doktoraturë. Siç është e zakonshme me sondazhet, ekziston një mbi-përfaqësim i atyre me arsim të lartë.

Sa i përket nivelit të punësimit të mostrës sonë, 44% raportuan të jenë punësuar në kohën e intervistës, 25% të papunë, 9% studentë, 10% në pension, 12% që përmbushin detyrat e caktuara, dhe pak të papërcaktuar. Lidhur me kategoritë e punësimit, 18% raportuan të jenë pozita profesionale ose teknike (të tilla si: mjek, mësues, inxhinier, artist, kontabilist, etj.), 4% pozita të larta administrative (të tilla si: bankier, drejtues në biznese të mëdha, zyrtar qeveritar, etj.), 4% pozita të sekretarisë (të tilla si: sekretar, menaxher i zyrës, mbajtës i librave, etj.),

12% pozita të shitjes (të tilla si: pronar dyqani, menaxher i shitjes, etj.), 5% pozita shërbyese (të tilla si: pronar restoranti, polic, kujdestar, etc.), 7% punëtor të kualifikuar (të tilla si: mekanik i motorit, elektrikist, etj.), 3% punëtor gjysmë të kualifikuar (të tilla si: vozitës autobusi, zdrukthtar, etj.), 2% punëtor të pakualifikuar (të tilla si: punëtor krahu, portier, etj.), 2% punëtor të fermës (të tilla si: fermer, punëtor krahu i fermës, etj.), 13% studentë, 21% amvise.

2.5. Analiza e të dhënave

Përgjigjet e pjesëmarrësve u futën në SPSS. Statistikat përshkruese, të tilla si frekuencat dhe kros-tabulimet në bazë të grupeve etnike, janë përdorur për të analizuar të dhënat. Ne gjithashtu kemi kontrolluar nëse rezultatet ndryshojnë sipas moshës, gjinisë, nivelit arsimor dhe gjendjes së punësimit.


3. Gjetjet: Rruga përpara dhe prapa

Kjo pjesë përshkruan gjetjet e këtij sondazhi në katër nën-kategori: **(i)** ndërprerja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; **(ii)** në rast të një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, a duhet Kosova të mbetet e pavarur apo të bashkohet me Shqipërinë; **(iii)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me tre skenarët për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (duke përfshirë arsyt kryesore për mbështetjen apo mungesën e mbështetjes në lidhje me tre skenarët); dhe **(iv)** perceptimi i qytetarëve të Kosovës lidhur me mbështetjen e politikës së Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.


3.1. Ndërprerja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Në lidhje me këtë çështje, është parashtruar pyetja si në vijim: **A pajtoheni me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?**

Gjetjet në lidhje me këtë çështje prodhuan peisazhin vijues: Gjysma e mostrës, 50% nga totali, nuk u pajtuan me ndërprerjen e dialogut (42% u shprehen se ata nuk pajtohen 'aspak' dhe më tej 8% u shprehën se pajtohen 'shumë pak'). Përafërsisht, 42% u shprehen se (12% u përgjigjën me 'disi' dhe 30% 'shumë') pajtoheshin me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 9% në mesin e pjesëmarrësve deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje. Prandaj, ekziston një ekuilibër i qartë në favor të vazhdimit të dialogut.



Vlerësimi i përgjigjeve për mostrat shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ngjashëm të përgjigjeve (edhe pse dallimet midis dy grupeve janë statistikisht të rëndësishme): 49% në mesin e shqiptarëve dhe rreth 61% në mesin e serbëve shprehen se pajtohen 'shumë pak' ose 'aspak' me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 43% në mesin e shqiptarëve dhe 27% në mesin e serbëve shprehen se pajtohen 'disi' ose 'shumë' me ndërprerjen e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 8% në mesin e shqiptarëve dhe 13% në mesin e serbëve deklarohen se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




3.2. A duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?


Sa i përket pyetjes nëse Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë, sondazhi ka paraqitur pyetjen e mëposhtme:

Nëse Kosova do të njihet nga Serbia, a duhet Kosova të kërkojë bashkim me Shqipërinë?


53% e mostrës totale u përgjigj me Kosova 'duhet patjetër' ose 'ndoshta duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia. 40% u deklaruan që Kosova 'definitivisht nuk duhet' ose 'ndoshta nuk duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia. 7% në mesin e pjesëmarrësve u deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Vlerësimi i përgjigjeve për mostrat shqiptare dhe serbe tregon një model të kundërt (dhe shumë të ndryshëm) të përgjigjeve, megjithatë: 57% në mesin e shqiptarëve dhe vetëm 15% në mesin e serbëve shprehen se Kosova ‘definitivisht duhet’ ose ‘ndoshta duhet’ të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia. 38% në mesin e shqiptarëve dhe 61% në mesin e serbëve shprehen se Kosova ‘ndoshta nuk duhet’ ose ‘definitivisht nuk duhet’ të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia (shih grafikun më poshtë). 5% në mesin e shqiptarëve dhe 25% në mesin e serbëve deklaruan se ‘nuk e di/nuk kam ndonjë mendim’ për këtë çështje.




Në një seri pyetjesh pasuese, sondazhi kërkon të kuptojë arsyet kryesore e të anketuarve se pse Kosova duhet ose nuk duhet të kërkojë bashkim me Shqipërinë. Mëposhtë, ne tregojmë dallimet midis shqiptarëve dhe serbëve lidhur me arsyet kryesore që Kosova duhet të kërkojë bashkim me Shqipërinë. Këto pyetje i'u janë parashtruar vetëm të anketuarve të cilët u përgjigjën se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë nëse njihet nga Serbia (57% shqiptarë dhe 15% serbë u janë përgjigjur pozitivisht bashkimit):



Siç mund të shihet, nga të anketuarit që ishin në favor të bashkimit, shqiptarët kishin pikëpamje pozitive të përfitimeve ekonomike, politike dhe aspiruese të bashkimit, ndërsa të anketuarit serbë ishin dukshëm më pak pozitiv për këto tri arsye.

Në kontekst të arsyeve për mos kërkimin e bashkimit, të anketuarit të cilët ishin përgjigjur se Kosova 'definitivisht nuk duhet' ose 'ndoshta nuk duhet' të kërkojë bashkim me Shqipërinë u pyetën një seri pyetjesh të ndryshme pasuese (mbani mend 38% e shqiptarëve dhe 61% e serbëve nuk dëshironin të kërkonin bashkim dhe kështu u pyetën këto pyetje të veçanta pasuese):



Këtu mund të shohim se të anketuarit shqiptarë që ishin kundër bashkimit ishin veçanërisht të prirur për të arsyetuar me përparësinë ndërkombëtare për të pasur dy shtete, dhe ishin shumë më pak të prirur për të theksuar përfitimet ekonomike.


3.3. Tre skenarët për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Pjesëmarrësit e sondazhit u njoftuan me opsionet/alternativat vijuese për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: a) vazhdimi i status kuosë; b) njohja de facto nga Serbia, në këmbim të kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës; dhe c) korigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB. Për sqarim, intervistuesit u shpjeguan të anketuarve, dhe gjithashtu ishte e sqaruar në pyetësor, se çfarë

nënkuptohet me status kuo⁹, njohje de facto dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive¹⁰.

3.3.1. Skenari i parë: Vazhdimi i status kuo-së

Sa i përket skenarit të parë, të anketuarve i'u është parashtruar pyetja në vijim: Sa jeni të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë? 7% e mostrës totale u përgjigjen me 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' rreth status kuo-së aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shih grafikun mëposhtë). Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve (89%) u përgjigjen me 'shumë pak' ose 'aspak i kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 4% u deklaruan me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




Analiza e veçantë e mostrës shqiptare dhe serbe tregon një model disi të ndryshëm të përgjigjeve. 6% në mesin e mostrës shqiptare dhe 17% në mesin e serbëve u shprehen me 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 91% në mesin e shqiptarëve krahasuar me 70% në mesin e serbëve janë 'shumë pak të kënaqur' ose 'aspak të kënaqur'


⁹Me status kuo, nënkuptohet mungesa e njohjes reciproke dhe marrëdhëniet politike dhe diplomatike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë të pezulluara.

¹⁰Me njohje de facto, nënkuptohet që Serbia i njeh institucionet e Kosovës por nuk do ta njohë shtetësinë e Kosovës; me kompetenca të zgjeruara ekzekutive, nënkuptohen fuqitë që do të përfshijnë ndryshimet kushtetuese në Kosovë dhe do të krijojnë entitet të ri politik në Kosovë, që do të ishte një njësi gjysmë autonome.

me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (shih grafikun mëposhtë). 3% në mesin e shqiptarëve dhe 13% në mesin e serbëve u përgjigjen me 'nuk e di/ nuk kam ndonjë mendim' për status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Këto dallime janë statistikiisht të rëndësishme (në nivelin 0.01), por rezultatet janë në përputhje me idenë se në të dy komunitetet ka një disponim për ndryshim.




Pastaj, ne vazhduam me një numër pyetjesh pasuese për arsyet kryesore se pse të anketuarit ishin apo nuk ishin të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të anketuarit që u përgjigjen me 'shumë i kënaqur' ose 'disi i kënaqur' me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, u shprehen si në vijim (shih grafikun mëposhtë) në lidhje me arsyet kryesore se pse ata ishin të kënaqur me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (mbani në mend se vetëm 6% e mostrës shqiptare dhe 17% e mostrës serbe ishin të kënaqur dhe kështu i'u janë parashtruar këto pyetje pasuese, prandaj përgjigjet janë bazuar në numra marginal):



Siç mund të shihet, as anketuesit shqiptarët e as serbë nuk ishin veçanërisht entuziastë për ndonjërin nga këto arsye për ruajtjen e status kuo-së, vetëm ajo e fundit – ka marrëdhënie të mira të punës me BE-në dhe OKB-në – arriti mbështetjen e shumicës nga mostra shqiptare.

Kthehemi prapë tek të anketuarit që ishin ‘aspak të kënaqur’ ose ‘shumë pak të kënaqur’ me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Këta të anketuar u pyetën paralelisht në seri të ndryshme të pyetjeve pasuese. (Mbani në mend se shumica e mostrave shqiptare (91%) dhe serbe (70%) ishin të pakënaqur me status kuo-në dhe prandaj u pyetën për këtë seri pyetjesh):




Siç mund të shihet, të anketuarit shqiptarë kishin më shumë gjasë të përmendnin mungesën e lëvizjeve konkrete drejt integrimit evropian si arsye për pakënaqësi, të ndjekur afër nga mungesa e njohjes globale, mungesa e njohjes nga Serbia, mungesa e prosperitetit ekonomik, dhe mungesa e zgjidhjes së problemeve të brendshme në mes të dy shteteve. Në anën tjetër, të anketuarit serbë kishin përparësi të ndryshme, sidomos duke u fokusuar në prosperitetin ekonomik dhe në problemet e brendshme të pazgjidhura.


3.3.2. Skenari i dytë: Njohja de facto nga Serbia, dhe kompetenca të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës

Lidhur me këtë skenar, pjesëmarrësve i'u parashtrua pyetja vijuese: A pajtoheni me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia? Një numër i vogël i pjesëmarrësve (9%) u deklaruan me 'fuqishëm pajtohem' ose 'disi pajtohem' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. Shumica e pjesëmarrësve


(86%) pohuan se 'disi nuk pajtohen' ose 'aspak nuk pajtohen' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia.



Analiza e përgjigjeve në mesin e mostrës shqiptare dhe serbe tregon modele shumë të kundërta të përgjigjeve. Vetëm 5% në mesin e shqiptarëve në krahasim me 48% në mesin e serbëve deklaruan se 'fuqishëm pajtohen' ose 'disi pajtohen' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. 93% në mesin e shqiptarëve krahasur me 35% në mesin e serbëve deklaruan me 'disi nuk pajtohem' ose 'fuqishëm nuk pajtohem' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. 2.5% në mesin e shqiptarëve dhe 17% në mesin e serbëve u deklaruan me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




Me një numër pyetjesh pasuese, sondazhi kërkoi të kuptonte arsyet kryesore për të cilat të anketuarit pajtoheshin apo nuk pajtoheshin me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia. Të anketuarit që u shprehën me ‘fuqishëm pajtohem’ ose ‘disi pajtohem’ me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, i’u parashtruan pyetjet në vijim (mbani në mend, vetëm 5% e mostrës shqiptare por 48% e asaj serbe i’u parashtruan këto pyetje):



Në mesin e të anketuarve serbë që i'u parashtruan këto pyetje pasuese, arsyeja më shpesh e dhënë ishte ajo për t'u dhënë serbëve më shumë zë në procesin e vendimmarrjes. Kjo arsye e dhënë nga një margjinë e konsiderueshme në mes të serbëve si arsye alternative ka të bëjë me integrimin e komunitetit serb në Kosovë dhe përmirësimin e marrëdhënieve me Serbinë.


Duke u kthyer prapa tek të anketuarit që u shprehën me 'fuqishëm nuk pajtohem' ose 'disi nuk pajtohem' me dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, një seri tjetër e pyetjeve pasuese u parashtruan (mbani në mend, 93% e mostrës shqiptare dhe 35% e mostrës serbe i'u parashtruan këto pyetje):



Siç mund të shihet, të anketuarit shqiptarë të cilët e kundërshtuan dhënien e kompetencave ekzekutive të AKS-së, u pajtuan fuqishëm se kompetenca të tilla mund të hapin derën për krijimin e një mini Republika Srpska, pasuar nga shqetësimet lidhur me ndarjen e komuniteteve në Kosovë dhe rritjen e tensioneve politike në mes Kosovës dhe Serbisë.


3.3.3. Skenari i tretë: Korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këmbim të njohjes globale të Kosovës, dhe hapjes së rrugës për anëtarësim në OKB

Përderisa ky skenar është parashtruar, të anketuarit u pyetën me pyetjen vijuese: Nëse korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultonte në njohje globale të Kosovës dhe do të hapte rrugën për anëtarësim në OKB, a duhet Kosova të mbështesë një marrëveshje të tillë për të korrigjuar kufinj të mbështesë opsionin e korrigjimit të kufirit i cili do të rezultonte në njohje globale të Kosovës dhe do të hapte rrugën për anëtarësim në OKB (shih grafikun mëposhtë). Në të kundërtën, 61% deklaruan se Kosova 'ndoshta nuk duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të mbështesë opsionin e korrigjimit të kufirit i cili do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugën për anëtarësim në OKB. 7% deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




Analiza e veçantë e mostrës shqiptare dhe serbe paraqet një model shumë të ngjajshëm të përgjigjeve. 32% në mesin e shqiptarëve dhe 33% në mesin e serbëve u shprehën se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të mbështesë skenarin e korrigjimit të kufirit nëse do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugë për anëtarësim në OKB. 62% në mesin e shqiptarëve dhe 55% në mesin e serbëve u shprehën se Kosova 'ndoshta nuk

duhet' ose 'definitivisht nuk duhet' të mbështesë skenarin e kufirit edhe nëse do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapte rrugë për anëtarësim në OKB. 6% në mesin e shqiptarëve dhe 12% në mesin e serbëve deklaruan se 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje. (Asnjë nga këto dallime përveç përgjigjeve 'nuk e di' ishin statistikisht të rëndësishme në mes të dy komuniteteve).




Me një numër pyetjesh pasuese, sondazhi kërkonte të kuptonte arsyet kryesore se pse të anketuarit do të mbështesin ose nuk do të mbështesin skenarin e korigjimit të kufirit. Të anketuarit të cilët janë përgjigjur se Kosova 'definitivisht duhet' ose 'ndoshta duhet' të mbështesë skenarin e korigjimit të kufirit nëse ky skenar do rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe hapjen e rrugës për anëtarësim në OKB, u pyetën pyetjet e mëposhtme (mbani në mend, 32% e mostrës shqiptare dhe 33% e mostrës serbe i'u janë parashtruar këto pyetje):



Ndër të anketuarit shqiptarë, të cilët u pyetën për këto pyetje pasuese, arsyeja më e shpeshtë e dhënë për mbështetjen ishte se kjo marrëveshje do të ishte e drejtë dhe më pak prej tyre gjithashtu mendonin se korrigjimi i kufirit do ta bënte Kosovën më të fortë dhe më të bashkuar brenda vendit. Respondentët serbë menduan se me marrëveshjen e korrigjimit të kufirit Kosova do të ishte një palë fitimtare për shkak të njohjes globale dhe anëtarësimit në OKB.

Duke u kthyer tek respondentët që u përgjigjën me Kosova 'definitivisht nuk duhet' ose 'ndoshta nuk duhet' të mbështesë skenarin e korrigjimit të kufirit nëse kjo do të rezultonte në njohjen globale të Kosovës dhe hapjen e rrugës për anëtarësim në OKB, i'u parashtruan pyetjet e mëposhtme (mbani në mend, 62% e mostrës shqiptare dhe 55% e mostrës serbe i'u janë parashtruar këto pyetje):



Sic mund të shihet, të anketuarit shqiptarë që ishin kundër skenarit të korrigjimit të kufirit më së shpeshti u pajtuan se Kosova është një shtet i pavarur të cilit duhet t'i jipet njohja globale dhe anëtarësimi në OKB pa pasur nevojë për marrëveshjen e korrigjimit të kufirit.

4. A e mbështesni politikën aktuale të SHBA-së dhe BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?


Lidhur me mbështetjen ndërkombëtare për marrëveshjen ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të anketuarve u është parashtruar pyetja si në vijim:

(a) A e mbështesni politikën aktuale të SHBA-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?

63% u përgjigjën me 'po' në mbështetje të politikës amerikane drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

21% u përgjigjën me 'jo', duke u shprehur kundër mbështetjes së politikës amerikane drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.


Dhe, 16% u përgjigjën me 'nuk e di / nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Analiza e përgjigjeve në mesin e mostrës shqiptare dhe serbe tregon një model tjetër të përgjigjeve. 70% në mesin e shqiptarëve dhe 5% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'po' duke treguar mbështetjen për politikën amerikane drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.


16% në mesin e shqiptarëve dhe 75% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'jo', duke u deklaruar kundër mbështetjes së politikës amerikane drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 14% në mesin e të anketuarve shqiptarë dhe 20% serbë u përgjigjën me

'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.




(b) A e mbështesni politikën e BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?

37% u përgjigjën me 'po', duke treguar mbështetje për politikën e BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 45% u përgjigjën me 'jo', duke u deklaruar kundër mbështetjes së politikës së BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dhe, 18% u përgjigjën me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



Analiza e përgjigjeve në mesin e mostrës shqiptare dhe serbe tregon një model tjetër të përgjigjeve. 39% në mesin e shqiptarëve dhe 11% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'po' për mbështetjen e politikës së BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 44% në mesin e shqiptarëve dhe 67% në mesin e serbëve u përgjigjën me 'jo', duke u deklaruar kundër mbështetjes së politikës së BE-së drejt arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obligative ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. 17% në mesin e respondentëve shqiptarë dhe 22% serbë u përgjigjën me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje.



5. Analiza Krahasuese

Në këtë seksion, ne i analizojmë dhe krahasojmë disa nga pyetjet kryesore nga sondazhi i dytë dhe i parë. Sondazhi i parë u realizua në dhjetor 2018 dhe i dyti në maj 2019. Qëllimi i sondazhit të dytë ishte të hulumtonte më thellë skenarët e 'finaleve të mëdha' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rrjedhimisht, sondazhi i dytë në shumë aspekte i ngjan sondazhit të parë, i cili ka metodologji të ngjashme, metoda për përzgjedhjen e komunave dhe përzgjedhje të mostrës. Shihni mëposhtë disa nga pyetjet kryesore dhe analizat krahasuese:

a) Ndërprerja ose mosndërprerja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?

Duket se ka një tendencë në rritje në drejtim të ndërprerjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në opinionin publik Kosovar (29% Sondazhi 1 - 42% Sondazhi 2). Megjithatë, ende shumica e popullatës është kundër ndërprerjes së dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (62% Sondazhi 1 - 50% Sondazhi 2). Analizat e mëtejshme tregojnë se tendenca në rritje për ndërprerjen e dialogut është e pranishme në të dy mostrat shqiptare (30% Sondazhi 1 - 43% Sondazhi 2) dhe mostrën Serbe (19% Sondazhi 1 - 27% Sondazhi 2).

Ndryshimi me kalimin e kohës është statistikisht i rëndësishëm ($p < 0.01$). Megjithatë, ka pasur disa ndryshime metodologjike përkatëse në mes të dy sondazheve (me kodet e përgjigjeve të ofruara në mënyrë të ndryshme në dy sondazhet). Prandaj nuk mund të përjashtojmë mundësinë që ndryshimi është një artefakt metodologjik. Para se të nxjerrim ndonjë konkluzion të saktë, ne duhet të kontrollojmë modelin e ndryshimit me kalimin e kohës për matjet e tjera kryesore.

b) A duhet Kosova të kërkojë bashkimin me Shqipërinë, nëse njihet nga Serbia?

Përderisa ka një zvogëlim të mbështetjes për vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ka një mbështetje më të madhe për bashkim me Shqipërinë. 43% në Sondazhin 1 krahasuar me 53% në Sondazhin 2 të mostrës së përgjithshme mbështetin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Në mënyrë të krahasueshme, 50% në Sondazhin 1 krahasuar me 40% në Sondazhin 2 e hodhën poshtë idenë e bashkimit. Analizat të mëtejshme tregojnë se mbështetja për bashkimin me Shqipërinë është rritur në mesin e mostrës shqiptare (44% Sondazhi 1 - 57% në Sondazhin 2) dhe në mesin e mostrës serbe (6% Sondazhi 1 - 15% Sondazhi 2). Duhet të theksohet se ka pasur një numër të lartë të përgjigjeve në mesin e të anketuarve serbë me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje (27% Sondazhi 1 - 25% Sondazhi 2).

Ky ndryshim është përsëri statistikisht i rëndësishëm ($p < 0.01$). Meqenëse pyetja është bërë në mënyrë identike në të dy sondazhet, ne mund të kemi më shumë besim në rezultat. Megjithatë mbizotëron e vërteta se opinioni qëndron mjaft i ndarë në mes të bashkimit me Shqipërinë dhe ruajtjes së status kuo-së mes dy shtetesh. Baraspesha e opinionit është zhvendosur, por jo në mënyrë vendimtare. Mund të jetë që opinioni do të mbetet mjaft i paqëndrueshëm për këtë çështje, e cila aktualisht mbetet hipotetike si çështje.

c) Tre skenarët alternativë për një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Sa i përket skenarit- **status kuo**- krahasimi i rezultateve tregon se ka një pakënaqësi në rritje me status kuo-në aktuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (79% Sondazhi 1 - 89% në Sondazhin 2). Kjo rritje është vërejtur edhe në mostrën shqiptare (82% Sondazhi 1 - 91% në Sondazhin 2) dhe në mostrën serbe (50% Sondazhi 1 - 70% në Sondazhin 2). Edhe një herë ndryshimi është statistikisht i rëndësishëm ($p < 0.01$). Një interpretim i mundshëm i këtij konstatimi është sesa më gjatë vazhdon bllokimi me disa çështje që kanë mbetur të pazgjidhura, aq më i madh është zhgënjimi i popullsisë në mungesë të progresit.

Skenari- **dhënia e kompetencave ekzekutive për Asociacionin/bashkësinë e komunave serbe të Kosovës, në këmbim të njohjes de facto të Kosovës nga Serbia**– rezultatet e përgjithshme, që janë në kundërshtim me këtë skenar, mbeten relativisht të qëndrueshme (84% Sondazhi 1 - 86% Sondazhi 2). Megjithatë, analiza e mëtejshme tregon një model të përmbysur të rezultateve midis mostrës shqiptare dhe serbe. Ndërmjet shqiptarëve ekziston një zvogëlim i mbështetjes për këtë skenar (9% Sondazhi 1 - 5% Sondazhi 2) dhe në mesin e serbëve ka një rritje të madhe në mbështetje të këtij skenari (16% Sondazhi 1 - 48% Sondazhi 2). Duhet të theksohet se në mesin e respondentëve serbë, përgjigja me 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje mbetet e lartë (25% Sondazhi 1 - 17% Sondazhi 2).

Ne duhet të kujtojmë se mostrat e të intervistuarve serbë janë mjaft të vogla (rreth 100 të anketuar në secilin nga dy sondazhet). Megjithatë, proporcioni në rritje i mostrave serbe që përkrahin kompetencat ekzekutive të zgjeruara për AKS është statistiki i rëndësishëm ($p < 0.05$). Prandaj duket se ka një rritje në shtrirjen e polarizimit ndërmjet dy komuniteteve në këtë çështje. Kjo mund të reflektojë edhe një herë zhgënjimin në çështjet e pazgjidhura ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Skenari – korrigjimi i kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rezultojë në njohjen globale të Kosovës dhe do të hapë rrugë për anëtarësim në OKB – rezultatet e përgjithshme, që mbështesin këtë skenar mbeten relativisht të qëndrueshme (30% Sondazhi 1 - 32% Sondazhi 2). Mbështetja në mesin e mostrës shqiptare është rritur paksa (30% Sondazhi 1 - 32% Sondazhi 2) dhe pak më shumë në mesin e serbëve (27% Sondazhi 1 - 33% Sondazhi 2). Duhet të theksohet se ka pasur një rënie të konsiderueshme në 'nuk e di/nuk kam ndonjë mendim' për këtë çështje në mesin e serbëve (26% Sondazhi 1 - 12% Sondazhi 2). Megjithatë, asnjë nga këto ndryshime nuk është statistiki i rëndësishëm.

6. Përfundimet

Qëllimi i këtij sondazhi ishte të kuptoheshin perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve (*Zëri i Popullit*) në lidhje me skenarët për 'Finalen e Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Numri i përgjithshëm i 1107 respondentëve në sondazhin tonë (87% shqiptarë, 9% serbë dhe 4% nga grupe të tjera etnike) e përbëjnë mostrën tonë përfaqësuese kombëtare të popullsisë së Kosovës. Ky sondazh, i realizuar në maj 2019, përsërit shumë pyetje nga sondazhi ynë i parë i cili u realizua në dhjetor 2018. Kështu na mundëson neve të shqyrtojmë ndryshimet gjatë pesë-gjashtë muajve të fundit. Sondazhi gjithashtu shtoi disa pyetje të reja duke eksploruar në thellësi arsyet e qytetarëve për preferencat e tyre rreth skenarëve të ndryshëm.

Në shumicën e aspekteve, sondazhi i tanishëm përsërit dhe përforcon gjetjet nga sondazhi i parë. Në veçanti ne gjejmë, ashtu si në sondazhin e parë, se:

- Ka mbështetje në të dy komunitetet shqiptare dhe serbe për vazhdimin e dialogut me Serbinë;
- Në të dy komunitetet ka pakënaqësi të konsiderueshme me status kuo-në;
- Ka shumë pak mbështetje në komunitetin shqiptar për dhënien e kompetencave të zgjeruara ekzekutive tek AKS, por disi më shumë në komunitetin serb;
- Ekziston një mbështetje e konsiderueshme në të dy komunitetet për korrigjimin e kufirit me Serbinë, me kusht që kjo të sjellë njohje globale, edhe pse përkrahësit për këtë skenar mbizotërohen nga ata që e kundërshtojnë.

Megjithatë, përdërisa linjat e përgjithshme kanë ndryshuar paksa, ka një numër treguesish se çfarë mund të interpretohet si frustrim në rritje me mungesën e progresit në zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Kështu, ka rritje të pakënaqësisë me status kuo-në dhe rënie të mbështetjes për vazhdimin e dialogut. Ka gjithashtu dëshmi shqetësuese për rritje të polarizimit ndërmjet dy komuniteteve mbi kompetencat ekzekutive të AKS-së.

Duke u kthyer në pyetjet pasuese për të cilat u pyetën të anketuarit rreth arsyeve të tyre, ne gjetëm dallime thelbësore në arsyetimin e dy komuniteteve. Në rastin e *skenarit të parë*, pakënaqësi me status kuo-në, respondentët shqiptarë kishin më shumë gjasa të përmendnin mungesën e lëvizjeve konkrete drejt integritit evropian si arsye për pakënaqësinë e tyre (88%), pasuar nga mungesa e njohjes globale (83%), mungesa e marrëdhënieve paqësore me Serbinë (76%), mungesa e prosperitetit ekonomik (76%), dhe mungesa e zgjidhjes së problemeve të brendshme ndërmjet dy komuniteteve (71%). Sidoqoftë, respondentët serbë kishin prioritete të ndryshme, veçanërisht duke u fokusuar në mungesën e prosperitetit ekonomik (50%) dhe në problemet e brendshme të pazgjidhura (47%).

Në rastin e *skenarit të dytë*, dhënia e kompetencave ekzekutive të AKS-së, respondentët serbë që ishin në favor të skenarit ishin veçanërisht të prirur për të dhënë më shumë si arsye të tyre, që të kenë më shumë zë në procesin e vendimmarrjes (62%). Kjo arsye u mbizotërua nga një diferencë e konsiderueshme midis serbëve që zgjodhën si arsye alternative integrimin e komunitetit serb në Kosovë (22%) dhe përmirësimin e marrëdhënieve me Serbinë (22%).

Në të kundërtën, respondentët shqiptarë, të cilët kundërshtuan dhënien e kompetencave ekzekutive të AKS-së, u pajtuan fuqishëm që kompetenca të tilla mund të hapnin derën për krijimin e një mini Republika Srpska (89%), pasuar nga shqetësimet lidhur me forcimin e ndarjeve mes komuniteteve në Kosovë (82%) dhe rritjen e tensioneve politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (80%).

Në rastin e *skenarit të tretë*, korrigjimi i kufirit në këmbim të njohjes globale, arsyeja mbizotëruese e kundërshtimit nga komuniteti shqiptar ishte se Kosova, si një shtet i pavarur, nuk duhet të heqë dorë nga territori për të fituar njohjen (93%). Ata gjithashtu ranë dakord se Serbia do të fitonte më shumë territor sesa Kosova (85%), dhe se përfitimet nuk ishin aq të mëdha (85%), dhe se korrigjimet kufitare mund të dobësonin vendin (77%).

Në mesin e shqiptarëve të cilët mbështetën skenarin e tretë, pati një humbje të plotë të mbështetjes për ndonjë nga arsyet e propozuara, edhe pse shumica mendonin se do të ishte e drejtë (66%) dhe do të forconte shtetin (57%), ndërsa vetëm (41%) mendonin se do të kishte përfitime të mëdha.

Në përgjithësi, perspektivat e të dy komuniteteve ndryshojnë krejtësisht në disa aspekte: të anketuarit serbë treguan shqetësim të veçantë për çështjet e brendshme që prekin komunitetin serb ndërsa të anketuarit shqiptarë, ndërkohë që ishin të shqetësuar për rreziqet e krijimit të një mini Republika Srpska, gjithashtu ishin të shqetësuar për çështjet e jashtme veçanërisht integrimin në BE dhe njohjen globale. Megjithatë, këto perspektiva të ndryshme nuk janë domosdoshmërisht kontradiktore reciprocikisht – për shembull integrimi në BE

nuk përbënë në vetvete ndonjë zgjidhje specifike për problemet e brendshme ndërmjet dy komuniteteve në Kosovë. Përgjigjet e të anketuarve sugjerojnë se, në këto aspekte, dialogu nuk duhet të jetë një lojë me përfitime të njëanshme 'zero sum game' ku çdo përfitim nga njëra palë duhet të jetë në kurriz të humbjeve për palën tjetër.

